

Vizita e Znj. Palmieri në UGJ

Znj Palmieri Konsullja e Përgjithshme e Italisë në Vlorë zhvilloi një vizitë pune në Universitetin e Gjirokastrës me Rektoren Z.Mema dhe Znj.Duri Zv/Rektore për Marrëdhëniet Ndërkombëtare, në ambientin e Rektoratit

Zonja Palmieri shoqërohej nga Z. Bilushi, Konsulli i Nderit të Italisë në Gjirokastrë dhe të pranishëm të tjerë. Rektori Mema pasi i uroj Z.Palmierit mireseardhjen dhe suksese në detyrën e re, bëri një prezantim të shkurtër të bashkëpunimeve të UGJ me universitetet italiane në fushën *akademike, studimore, botuese, kulturore etj.* Në fjalën e tij Z.Mema vuri theksin në ndërkombëtarizimin e programeve të studimit dhe në këtë kontekst, evidentoi angazhimin e përbashkët me Universitetin e Maceratës për *hapjen e programit të ciklit të dytë master I shkencave me titull të dyfishtë* në fushën e Administrimit të pasurive historike dhe kulturore. Për jetëzimin e këtij programi të rëndësishëm për UGJ dhe studentet, të cilët do të përfitojnë një diplomë të dytë dhe të njohur në tregun evropian të punës, Rektori Mema kërkoi mbështetjen e institucioneve dhe strukturave diplomatike italiane.

Zonja Palmieri në fjalën e saj shprehu gadishmërinë për vazhdimin dhe zgjerimin e këtij bashkëpunimi në të ardhmen.

